



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 gusht 2021
Nr. ref.:RK 1826/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI80/21

Parashtrues

Shefqet Ahmetaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 265/2020, të 14 janarit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shefqet Ahmetaj, me vendbanim në fshatin Padalishtë, komuna e Istogut (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), [Rev. nr. 265/2020] të 14 janarit 2021, në ndërlidhje me Aktvendimin [Ac. nr. 1028/16] të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës së Apelit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon të jenë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 prill 2021, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të cilën ai e kishte dorëzuar në postë më 28 prill 2021.
6. Më 6 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 20 maj 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë formularin zyrtar të kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të

Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KI80/21, caktoi gjyqtarin Radomir Laban si gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.
11. Më 10 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës, si dhe vendimet e gjykatave të rregullta të cilat i kishte dorëzuar edhe në kërkesën e tij fillestare.
12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 29 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

14. Nga shkresat e rastit rezulton se duke filluar nga 1 janari 2006 deri më 31 dhjetor 2006, dhe pastaj nga 2 janari 2007 deri më 30 qershor 2007, parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune në pozitën oficer korrektues në Qendrën Korrektuese në Dubravë-Ministria e Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi).
15. Më 24 gusht 2007, punëdhënësi kishte nxjerrë Aktvendim me nr. [Ref. 245/07] për pezullimin e marrëdhënies së punës për parashtruesin e kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ky i fundit ishte përgjegjës për arratisjen e të burgosurve nga qendra e burgimit. Vendimi në fjalë parashihte, ndër të tjera, se pezullimi i marrëdhënies së punës mbetej në fuqi deri në përfundimin e procedurës disiplinore dhe hetimore.
16. Më 28 shkurt 2008, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, përmes Vendimit [nr. 20] i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës, duke e konsideruar se ky i fundit ishte përgjegjës për shkelje të rëndë të nenit 30. 1 (a) (b) dhe (c) të Kodit të Mirësjelljes.
17. Më 31 mars 2008, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Komisionin e Ankesave të Punëdhënësit, kundër Vendimit të lartpërmendur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
18. Më 29 prill 2008, Komisioni i Ankesave të Punëdhënësit përmes Vendimit [KA/031/2008] refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Vendimin [nr. 20] të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë.

19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPMK), me propozimin që të anulohet Vendimi [nr. 20] i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar si në vijim: i) të kthehet në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës.
20. Më 3 shtator 2008, KPMK, përmes Vendimit [A 02/162/2008], refuzoi kërkesën e parashtruesit dhe në këtë mënyrë kishte lënë në fuqi të gjitha vendimet paraprake.
21. Më 2 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Pejë, përmes Aktgjykimit [P. nr. 6/014] kishte liruar parashtruesin e kërkesës nga akuza për kryerjen e veprës penale nga neni 314 par. 2 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës.
22. Në një datë të paspecifikuar, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Pejë.
23. Më 23 shkurt 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA. nr. 135/015] kishte refuzuar ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Pejë.
24. Më 10 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Pejë, me propozimin që të anulohet Vendimi [nr. 20] i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar si në vijim: i) që të kthehet në vendin e punës; dhe ii) t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale.
25. Më 21 janar 2016, Gjykata Themelore në Pejë, dega në Istog, përmes Aktgjykimit [C. nr. 211/015], i) aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës; ii) obligoi punëdhënësin që parashtruesin ta kthejë në vendin e punës; iii) obligoi punëdhënësin që t' i bartë shpenzimet procedurale në vlerë prej 509 euro. Gjykata Themelore në Pejë, arsyetimin e Aktgjykimit të saj e bazoi kryesisht në faktin se parashtruesi i kërkesës ishte shpallur i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohej dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Ligjit për Shërbyesit Civilë, nr. 2010/03-149, parashihet se nëse nëpunësi civil i akuzuar për veprën penale shpallet i pafajshëm ai do të kthehet në vendin e punës.
26. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Pejë, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 19 shkurt 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 1028/16] aprovoi si të bazuar ankesën e punëdhënësit dhe hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të paafatshme. Në arsyetim të Aktvendimit tutje theksohet se *"Gjykata e Apelit duke e ekzaminuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sipas pretendimeve ankimore të të paditurës gjen se një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar për shkak se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje thelbësore*

të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2 pika (e) e LPK-së, e për shkak të shkeljes që kualifikohet në kuptim të dispozitës së nenit 182, paragrafi 2 pika (e) e LPK-së, gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket afatit për paraqitjen e padisë në gjykatë. Në kuptim të afatit që përcaktohet me këtë dispozitë rrjedh se padia e paditësit për anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës me të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës është e paafatshme, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë për kthim në vendin e punës në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur me datë 10.08.2015, ndërsa paditësi nga vendi i punës ishte larguar sipas vendimit të komisionit disiplinor nr. 20 të dt. 28.02.2008, i cili vendim është vërtetuar me vendimin e Komisionit të ankesave të Organit Punëdhënës / Ministria e Drejtësisë nr. KA/031 12008 të datës 29.04.2008. Po ashtu edhe me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, A 02/162/2008 të datës 03. 09. 2008 është refuzuar ankesa e paditësit dhe janë lënë në fuqi vendimet paraprake, pra padia është paraqitur pasi ka kaluar afati ligjor për paraqitjen e padisë. Gjykata e Apelit për paafatshmërinë e padisë iu referua dispozitës së nenit 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, pasi që ligj i aplikueshëm për afatin në kohën kur është larguar paditësi nga puna ka qenë ky ligj”.

28. Më 10 prill 2020, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit [Ac. nr. 1028/16] të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
29. Më 14 janar 2021, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 265/2020] refuzoi si të pabazuar revizionin dhe Aktvendimin [Ac. nr. 1028/16] të Gjykatës së Apelit e cilësoi si të drejtë dhe të ligjshëm.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se Aktvendimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 265/2020] i 14 janarit 2021, në ndërlidhje me Aktvendimin [Ac. nr. 1028/16] të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës së Apelit shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
31. Parashtruesi i kërkesës fillimisht para gjykatës pretendon se vendimet e kontestuar nuk janë mjaftueshëm të arsyetuar.
32. Parashtruesi i kërkesës më tutje në kërkesën e tij pretendon se procedura e ndjekur në Komisionin Disiplinor të Punëdhënësit, më tutje në Komisionin e Ankesave dhe në KPMK, ishin të padrejta, duke theksuar se “janë marrë në kundërshtim me parimin ligjor të prezumimit të pafajsisë e janë shqiptuar masa disiplinore e ndërprerjes së marrëdhënies së punës pa përfunduar procedura penale”. Parashtruesi në kërkesën e tij thekson se në rastin e tij ka qenë duke u zhvilluar procedura penale, dhe sipas tij punëdhënësi nuk ka mundur të ndërmarr veprime deri në përfundimin e procedurës penale. Në ndërlidhje me këtë parashtruesi shton se “Gjykata nuk mund të vendos por

duhet të ndërpres gjykimin siç është paraparë me dispozitën e nenit 278.2 e lidhur me nenin 13 të LPK-së”.

33. Parashtruesi më tutje shton se në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 17, paragrafi 1 të Ligjit nr. 02/L-028 mbi Procedurën Administrative.
34. Parashtruesi në fund kërkon nga Gjykata që kërkesa të shpallet e pranueshme dhe të shpallen të pavlefshme, Aktvendimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 265/2020] i 14 janarit 2021, në ndërlidhje me Aktvendimin [Ac. nr. 1028/16] të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës së Apelit dhe të lihet në fuqi Aktgjykimi [C. nr. 211/015] i Gjykatës Themelore.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI PËR TË DREJTAT THEMELORE NGA MARRËDHËNIA E PUNËS (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 60/89)

Neni 83

Punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të organit kompetent në organizatë ose në qoftë se ky organ nuk merr vendimin brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, përkatësisht të kundërshtimit, ka të drejtë që në afatin e ardhshëm prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente.

Ai nuk mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave para gjykatës kompetente në qoftë se paraprakisht nuk ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave para organit kompetent në organizatë, përveç të së drejtës për kërkesën monetare.

Organi punëdrejtues ose personi i autorizuar në organizatë, përkatësisht punëdhënësi, është i obliguar që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit, të përmbarojë vendimin e plotfuqishëm të gjykatës i cili është marrë në procedurën për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në qoftë se në vendimin gjyqësor nuk është përcaktuar një afat tjetër.

Nëse organi punëdrejtues ose personi i autorizuar në organizatë nuk e përmbaron vendimin e gjykatës nga paragrafi 3 të këtij neni, ai kryen shkelje të rëndë të detyrës së punës për shkak të së cilës i shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 182

[...]

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

[...]

e) në qoftë se është vendosur për kërkesën sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj;

LIGJI NR. 02/L-28 PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

Neni 17

Çështje paraprake, që zgjidhen nga organe të tjera

17.1. Në rast kur vendimi përfundimtar në procedim administrativ kushtëzohet nga marrja e një vendimi paraprak, i cili, nga ana e tij, është në kompetencë të një organi tjetër të administratës publike ose të gjykatës, organi që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar pezullon procedimin administrativ derisa organi tjetër ose gjykata të marrin vendimin paraprak.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

37. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtguesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afat]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

38. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; ka qartësuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, konkretisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 265/2020] i 14 janarit 2021, në ndërlidhje me Aktvendimin [Ac. nr. 1028/16] të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës së Apelit; ka specifikuar të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar; si dhe ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor.
39. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që t'i shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin K104/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, gjithashtu rastin K175/20, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një

“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e pranueshmërisë, i 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, gjithashtu shih rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).

42. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 28 si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 39).
43. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërldhet me Vendimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, e cila përmes Vendimit [nr. 20] i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës parashtruesit, duke konsideruar se ky i fundit i cili ishte në cilësinë e oficerit korrektues, kishte bërë shkelje të rënda të Kodit të Mirësjelljes. Më pas, parashtruesi i kërkesës kishte bërë ankesë kundër Vendimit të lartpërmendur në KPMK, e cila e kishte refuzuar ankesën. Në vitin 2014, Gjykata Themelore kishte shpallur të pafajshëm parashtruesin e kërkesës, për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar. Ky Aktgjykim ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit. Pas kërkesëpadisë së parashtruesit drejtuar Gjykatës Themelore, për kthim në vendin e punës, kjo e fundit aprovoi padinë, duke e obliguar punëdhënësin që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e punës. Pas ankesës së punëdhënësit në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit pranoi ankesën e punëdhënësit si të bazuar dhe kërkesëpadinë e parashtruesit e hodhi poshtë si të paafatshme. Gjykata Supreme Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e vërtetoi duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm.
44. Gjykata rikujton se këto konstatime të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës, duke pretenduar në esencë, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së arsytimit të vendimeve gjyqësore, në mënyrë specifike Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 265/2020] të 14 janarit 2021, në ndërldhje me Aktvendimin [Ac. nr. 1028/16] të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës së Apelit si dhe aplikim të gabuar të dispozitave ligjore.
45. Gjykata në vijim pretendimet e parashtruesit të kërkesës do t’ i trajtojë së bashku, pasi që të njëjtat janë të ndërldhura dhe se parashtruesi i kërkesës të njëjtat i ka elaboruar si të ndërldhura.
46. Fillimisht, Gjykata rikujton se pretendimet të cilat parashtruesi i kërkesës i ngritë në Gjykatë, të njëjtat i ka ngritur edhe para gjykatave të rregullta.

47. Gjykata edhe një herë rikujton pretendimet e parashtruesit të kërkesës i cili para Gjykatës pretendon se gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të nenit 17, paragrafi 1 të Ligjit nr. 02/L-028 mbi Procedurën Administrative, dhe si rezultat vendimet e tyre nuk janë mjaftueshëm të arsyetuara.
48. Gjykata, fillimisht, vë në dukje se praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastin e Gjykatës KI185/19, parashtrues: *Abdylhadi Petlla*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2020, paragrafi 40). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t' i përmbahet këtij parimi (shih rastet e Gjykatës KI185/19, cituar më lart, paragrafi 40; KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme duke arsyetuar pretendimet e parashtruesit që ndërlidhen me afatin për paraqitjen e padisë, theksoi se këto pretendime janë të pabazuara pasi konstatoi se Gjykata e Apelit me të drejtë ka aplikuar dispozitat e nenit 83, paragrafi 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, pasi i njëjti ishte i aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Në ndërlidhje me atë që u tha më lart, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme, e cila, ndër të tjera, arsyetoi si në vijim: *"Pretendimi sipas revizionit se gjykata e shkallës së dytë, në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Shërbyesit Civilë nr. 03-L - 149, nenin 63 pika 3, sipas të cilit e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit sepse kjo dispozitë sqaron: "Në rast të inicimit të procedurës penale kundër nëpunësit civil për kryerjen e veprës penale gjatë ushtrimit të mandatit të tij/saj administrativ, që mund të rezultojë në krijimin e kushteve për ngritjen e padisë kundër nëpunësit civil, të gjitha procedurat disiplinore lidhur me rastin nuk mund të iniciohen deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente.", është pretendim tërësisht i pabazuar, pasi vendimi i Komisionit Disiplinor të paditurës – Organi Punëdhënës Qendra Korrektuese në Dubravë - Ministria e Drejtësisë me nr. prot. 20, i datës 28.02.2008, është nxjerrë para hyrjes në fuqi me 11.07.2010, të Ligjit mbi Shërbyesit Civilë nr. 03-L - 149, të cilit i referohet gjykata e shkallës së parë, andaj edhe nuk ka mundur të zbatohet, dhe paditësi nuk mund të thirret në aplikimin e kësaj dispozite.*

Gjykata e shkallës së dytë me të drejtë ka aplikuar në rastin konkret dispozitat e nenit 83, paragrafi 1, të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës (Gazeta Zyrtare e RSFJ 60/89) përcaktohet se "Punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent në organizatë, ose në qoftë se ky organ nuk merr vendimin brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, përkatësisht të kundërshtimit, ka të drejtë që në afatin e ardhshëm prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente", i cili ligj është i aplikueshëm në rastin konkret sipas rregullores së UNMIK/RREGI1999/24, të datës 12 dhjetor 1999, për Ligjin në fuqi në

Kosovë, pasi paditësi ka dështuar që padinë ta parashtroj brenda afatit të përcaktuar ligjor”.

50. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës se: (i) Gjykata e Apelit lidhur me mos aplikimin e nenit 63 të Ligjit mbi Shërbyesit Civilë, duke i sqaruar parashtruesit se Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit është nxjerrë para hyrjes në fuqi me 11 korrik 2010, të Ligjit mbi Shërbyesit Civilë, nr. 03/L-149, të cilit i referohet gjykata e shkallës së parë, andaj edhe nuk ka mundur të zbatohet, dhe paditësi nuk mund të thirret në aplikimin e kësaj dispozite (ii), Gjykata Supreme kishte theksuar se Ligji për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës ishte i aplikueshëm në rastin konkret konform Rregullores së UNMIK-ut nr. 24/1999, dhe në bazë të së cilit pala e pakënaqur kishte 30 (tridhjetë) ditë afat për paraqitjen e padisë, dhe në rastin para nesh padia, ishte ushtruar jashtë afatit të paraparë.
51. Nga sa më sipër, Gjykata vë në pah se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideron të rëndësishme për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës nr. KI118/17, parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29)
52. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil (shih rastin e Gjykatës KI185/19, cituar më lart, paragrafi 46).
53. Në këtë drejtim, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 i KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës (shih, rastin e Gjykatës KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
54. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të

miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli parësor i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin e Gjykatës KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

55. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngre pretendim të argumentueshëm kushtetues për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, rastet Gjykatës KI185/19, cituar më lart, paragrafi 49; dhe KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42; shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur – Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
56. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, konkretisht e drejta për një gjykim të drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.
57. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin dhe 39 (2) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Radomir Laban



Gresa Caka-Nimani